

Forcat serbe e nisën sulmin kundër forcave të UÇK-së në Llaushë/Lauša dhe fshatrat përreth në mëngjesin e datës **5.03.1998**. Sadiku me bashkëshorten dhe fëmijët u strehuan në pyllin *Bajrak*. Nga ora 14:00, Sadiku shkoi në shtëpi për ta lëshuar bagëtinë në kullotë. Afro dhjetë minuta më vonë, nga drejtimi nga i cili shkoi u dëgjuan disa të shtëna. Familjarët dyshonin se diçka e keqe do të mundte t'i ndodhte Sadikut. E kanë pritur atë ditë, por ai nuk u kthye në pyll. Tri ditë më vonë, një banor i fshatit e ka gjetur trupin e pajetë të Sadikut në pyllin *Bajrak* [**Llaushë/Lauša**]. Familjarët e kanë varrosur Sadikun më 10.03.1998 në varrezat e *Mëhallës Jashari* në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze. Pas lufte, më 27.04.2001, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në varrezat e Llaushës/Lauša.

Burimet: deklarata N.K, FDH-17308; J. Martinsen, *Regjistri...*, *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oruzanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 130-131, FDH-23807.

Miftar (Smajl) Rrecaj

(25.06.1956, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Para lufte, Miftari punonte në Fabrikën e Municionit në Skënderajt/Srbica. Me bashkëshorten Zojen, tri vajza dhe tre djem jetonin në Llaushë/Lauša. Nga fundi i muajit dhjetor të vitit 1997, aderoi në njësitin lokal të UÇK-së. Kur forcat e shumta serbe e vendosën rrethimin e fshatit në mëngjesin e datës **5.03.1998**, Miftari me disa bashkëluftëtarë u nisën për ta vëzhguar terrenin. Te *Malet e Popranit/Popranove šume* [**Llaushë/Lauša**] u ndeshën me forcat serbe. Gjatë shkëmbimit të zjarrit, Miftarin e kanë plagosur rëndë në gjoks dhe kraharor. I vëllai Rexha dhe i biri Nusreti e kanë bartur në shtëpi, ku një mjek i dha ndihmën e parë. Ka dhënë shpirt një ditë më vonë. Familjarët e kanë varrosur Miftarin në varrezat e *Mëhallës Rrecaj*, në afërsi të xhamisë së fshatit.

Burimet: deklarata N.R, FDH-32461; J.

Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 130-131, FDH-23807.

Fatime (Bajram Sylejmani)

Gashi

(1947, rome nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, dymbëdhjetë fëmijë)

Makfirete (Bajram) Gashi

(1975, rome nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica)

Gazmend (Bajram) Gashi

(1980, rom nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës)

Fatimja dhe bashkëshorti Bajrami i kishin dymbëdhjetë fëmijë. Jetonin në Llaushë/Lauša. Familjarët e saj merreshin me bujqësi dhe tregti. Një ditë para sulmit mbi Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze [4.03.1998], ushtria i solli dhe i stacionoi pranë shtëpisë së tyre dy tanke, ndërkaq në ditën kur u ndërmor sulmi, një nga tanket u parkua në oborrin e familjes Gashi. Meqë gjatë tërë kësaj dite [**5.03.1998**] zhvilloheshin luftimet dhe u dëgjonin krismat e fuqishme, Fatimja dhe Bajrami morën vendim që të zhvendoseshin dhe me fëmijë u nisën drejt Polacit/Poljance. Te vendi i quajtur *Betoni i Polacit/Beton Poljanca* [**Polac/Poljance**], forcat serbe hapën zjarr mbi familjen Gashi dhe i qëlluan Fatimen, të bijën Makfireten dhe të birin Gazmendin, i cili ngrykë e mbante motrën Arjetën, një vjeçe. Të shtënat zgjatën gjysmë ore. Kur ato pushuan, pjesëtarët të forcave serbe iu afruan familjarëve të viktimave dhe i lejuan Bajramit dhe të tjerëve që t'i merrnin me vete trupat e pajetë të Fatimes, Gazmendit dhe Makfiretes. Pas tri ditësh, familjarët i kanë çuar trupat e Fatimes, Gazmendit dhe Makfiretes në oborrin e depos së materialit dhe pajisjeve ndërtimore *Lah Tushila* në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze, ku gjendeshin trupat e shqiptarëve të tjerë të vrarë në luftimet në rajonin përreth. Fatimja, Makfretja dhe Gazmendi u varrosën më 11.03.1998 në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze. Pas lufte, në muajin qershor të vitit 2001, familjarët i kanë rivarrosur trupat e tyre në Llaushë/Lauša.